

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Obiliqit z. Mehmet Krasniqi**

I nderuari z. Krasniqi,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, ju keni premtuar:

- Hapjen e vendeve të reja të punës, me ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”;
- Furnizimin me energji elektrike 24 orë në ditë;
- Ndërtimin e shkollës të reja dhe cilësi në arsim;
- Reformimin e administratës;
- Rrugë të reja, asfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra;
- Ndërtimin e shtëpisë së kulturës;
- Ndërtimin e urës në Hamidi;
- Kanalizimin në fshatin Sibofc;
- Ujësjetësin në fshatrat Brenicë dhe Kozaricë;
- Ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Lajthishtë;
- Ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Babimoc;
- Ndërtimin e 3 shkollave, 20% i ujësjetësit, 40% i kanalizimit dhe 10% i asfaltit përgjatë mandatit 4 vjeçar;
- Mbrojtjen e ambientit,
- Rrymë më të lirë për 25%,
- Përmirësimin e shërbimeve komunale, me theks të veçantë përmirësim të infrastrukturës rrugore, ujësjetësit, kanalizimit, furnizim me energji elektrike dhe trajtim të mbeturinave.

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)